



Agjencia e Akreditimit e Kosovës
Kosovo Accreditation Agency
Agencija za Akreditovanje Kosova

Angazhimi i studentëve në qeverisjen e arsimit të lartë dhe sigurimin e cilësisë duhet të bazohet në këto parime

akreditimi.rks-gov.net





Pavarësia

Studentët duhet të shprehin mendimet e tyre në mënyrë të pavarur, pa frikë dhe pa ndikim nga palët e treta.



Të qenit të hapur

Angazhimi i studentëve në zhvillimin e arsimit të lartë duhet të jetë një mundësi ku kanë mundësi qasjeje të gjithë studentët, pavarësisht performancës së tyre akademike, vitit të studimit, statusit financiar, gjinisë apo ndonjë kriteri tjetër diskriminues.



Demokracia

Përfaqësuesit e studentëve duhet të zgjidhen nga të gjithë studentët e institucionit/fakultetit dhe duhet të jenë në gjendje të ngritin zërin e tyre dhe të votojnë për të gjitha çështjet.



Përfaqësimi

Studentët e zgjedhur duhet të ndërtojnë dhe të mirëmbajnë komunikim efektiv me elektoratin e tyre. Në pozitat e tyre të zgjedhura, studentët kanë për obligim të sigurojnë se mendimet e tyre bazohen në konsultimet e elektoratit dhe nuk janë të ndikuara nga ndonjë palë e tretë.



Transparenca

Procesi i zgjedhjes së përfaqësuesve të studentëve duhet të bazohet në thirrje të hapura dhe transparente.

Integriteti

Institucionet duhet të promovojnë dhe mundësojnë integritetin e studentëve. Studentët e zgjedhur duhet të demonstrojnë vazhdimisht ndershmëri, drejtësi dhe mirësjellje dhe duhet t'i përmbahen kodit të vlerave morale.

Studenti si partner

Studentët duhet të konsiderohen si partnerë nga ana e institucioneve të arsimit të lartë, dhe jo si klient apo konsumatorë. Institucionet duhet të kuptojnë që perspektivat e studentëve sjellin vlerë të shtuar në rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit të lartë.

Gjithë përfshirja dhe diversiteti

Përfaqësuesit e studentëve duhet të punojnë që të sigurojnë se natyra diverse e trupave studentore ruhet dhe pasqyron nivelin e diversitetit të popullatës në përgjithësi.



Studentët si bashkë krijues

Studentët nuk duhet të shërbejnë vetëm si burim i vlefshëm i marrjes së informatave kthyesë për cilësinë e kushteve të tyre të studimit dhe jetës studentore, ata duhet të konsiderohen si partner të besueshëm me rol të rëndësishëm në proceset e hartimit dhe ofrimit të arsimit të lartë.

Kolegjialiteti dhe barazia e vlerësimit

Institucionet dhe autoritetet vendore, si dhe përfaqësuesit e studentëve duhet të promovojnë kolegjialitetin ndërmjet stafit dhe studentëve në të gjithë sektorin e arsimit të lartë.

Profesionalizmi dhe mbështetja

Studentët dhe përfaqësuesit e studentëve duhet të kontribuojnë plotësisht dhe të veprojnë në mënyrë profesionale kur përfshihen në strukturat dhe proceset e institucioneve të arsimit të lartë. Është përgjegjësi e institucioneve të sigurojnë mbështetjen e nevojshme për përfaqësuesit e studentëve që ata të kenë mundësi të përmbushin rolin e tyre.



Informatat kthyese

Institucionet duhet të mirëpresin dhe të inkurajojnë marrjen e informatave kthyese, të hapura dhe të menjëhershme, nga studentët. Institucionet duhet të sigurojnë që studentët kanë mundësi të japin komente me lehtësi, në mënyrë të sigurt dhe të vlefshme.

Vetë kritika dhe përmirësimi

Përfaqësuesit e studentëve dhe institucionet duhet të jenë vetë-analitik dhe autokritikë ndaj praktikave të tyre të angazhimit të studentëve. Duhet të përdoren teknika të bazuara në fakte për të vlerësuar, kritikuar dhe avancuar vazhdimisht efektivitetin e strategjive për ndërtimin e një kulture të përfshirjes së studentëve në institucionin e arsimit të lartë.

Konsistenca

Institucionet dhe përfaqësuesit e studentëve sigurojnë që vlerat dhe praktikat e përfshirjes së studentëve zbatohen në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë institucionin.

